



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE NGRITJE NË DETYRË DHE PËR PRANIMIN
NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË E ULET DHE TË MESME DREJTUESE.
(Përgjegjës)**

Lloji i diplomës “Diplomë të nivelit “Master Shkencor ”në Shkenca Shoqerore/Humane.

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM 142 datë 12.03.2014”Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar si dhe të kreut II, III, IV të Vendimit nr.242 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave,i ndryshuar “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Bashkia Mallakastër shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit nga jashte sistemit të shërbimit civil për pozicionin :

- Përgjegjës i Njesisë së Integritimit Europian, kategoria: **III-a/1**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil. Nëse nuk ka një fitues nga procedura e lëvizjes paralele ose ngritje në detyrë, plotësimi i vendit vakant do të realizohet në procedurën e pranimit në shërbimin civil. Për të tre Procedurat aplikohet në të njëjtën kohë.

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
LEVIZJE PARALELE:**

05.11.2021

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	<u>10.11.2021</u>
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	<u>10.11.2021</u>

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

Përshkrimi i Punës

1.

Njësia e Koordinimeve me Bashkimin Europian ka mision administrimin e çështjeve që lidhen me promovimin e vlerave të territorit me qëllim nxitjen e donatoreve, vendas apo të huaj, forcimin e bashkëpunimit me partner të huaj dhe vendas me qëllim zbatimin, menaxhimin, mbikqyrjen dhe koordinimin e projekteve të ndërmarrë me qëllim përmbushjen e interesave ekonomikë, social, kulturorë apo sportivë të njësisë së qeverisjes vendore si dhe ofrimin e shërbimeve dhe lehtësimin e procedurave për të gjithë donatorët apo investitorët të huaj apo vendas, që ndërmarrin nisma në territorin e Bashkisë Mallakastër.

Rritjen e përgjegjësisë për monitorimin e zbatimit të strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për strukturat në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës

1. LËVIZJA PARALELE

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar)
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/Humane.
2. Të kenë eksperiencë pune (në profil të njëjtë) jo më pak se 5 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore .
3. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
4. Të kenë të mbrojtur (certifikuar) gjuhën angleze ose një gjuhë pjesë e BE.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë**, në zyrën e **Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim te gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore.(Dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 05.11.2021.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 06/11/2021, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën paraprake të kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes emailit të paraqitur nga kandidati

në dokumentacionin e aplikimit. Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësine Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore **brenda 5 ditëve kalendarike**.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil.
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 04.2.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- VKM 450 , datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe Kordinimin e procesit të Integrimit Evropian , ndërmjet qeverisjes qendrore dhe Njësine të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhezimi për zbatimin e VKM nr.450 datë 26.07.2018.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243 dt.18.03.2015

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

2. NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqerore/Humane.
2. Të kenë eksperiencë pune (në profil të njëjtë) jo më pak se 5 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore .
3. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
4. Të kenë të mbrojtur (certifikuar) gjuhën angleze ose një gjuhë pjesë e BE.

2.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i aplikantit, letër motivimi.
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda **datës 10.11.2021**

2.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.11.2021**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nejrëzore, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;
2. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
3. Ligji 152/2013 “Për nënpuënsin civil”, I ndryshuar.
4. Kodi I Punës së Republikës së Shqipërisë me Nr.9761, datë 12.07.1995, I ndryshuar
5. Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
6. Njohuritë mbi ligjin 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
7. VKM 450, datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe Kordinimin e procesit të Integritetit Evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe Njësive të vetëqeverisjes vendore”.
8. Udhezimi për zbatimin e VKM nr.450 datë 26.07.2018

2.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATË

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E

 KOMUNIKIMI

Komisioni i Ngritjes në detyrë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, i ve në dispozicion listën e fituesve, Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kandidatët pavarësisht të drejtës për tu ankuar në Gjykatën administrative kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në standën e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.
- Shërbimin kombëtar të punësimit

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

3.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

-Për pozicionin Përgjegjës, i Njesisë së Integritetit Europian, klasa III-a/1

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/Humane
2. Të kenë eksperiencë pune (ne profil të njëjtë) jo më pak se 5 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore .
3. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
4. Të kenë te mbrojtur(certifikuar) gjuhën angleze ose një gjuhë pjesë e BE.

3.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Jetëshkrim i aplikativ dhe letër motivimi.
2. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID); ;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;;
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentacioni dorëzohet pranë Zyrës së Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër deri më date 10.11.2021.

3.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14.11.2021 NJBNJ do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në stendën e informimit të publikut, **listën e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e ulët drejtuese** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit., në rrugë elektronike nëpërmjet emailit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj.

3.4.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;
2. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
3. Ligji 152/2013 “Për nënpuënsin civil” , I ndryshuar
9. Ligji 7961 datë 12.07.1995,”kodi I punës në Republikën e Shqipërisë”.i ndryshuar.
10. Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
11. Njohuritë mbi ligjin 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
12. VKM 450 , datë 26.07.2018 “”Për bashkërendimin dhe Kordinimin e procesit të Integrimit Evropian , ndermjet qeverisjes qendrore dhe Njësine te vetëqeverisjes vendore”.
13. Udhezimi per zbatimin e VKM nr.450 datë 26.07.2018

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

3.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimi**t, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin Përgjegjës i Njesisë së Integritetit Europian, kategoria III-a/1

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brenda 24 (njëzet e katër) orëve, i vendos në dispozicion listën e fituesve, Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

(Një pozicion)- Përgjegjës i Sektori Njesisë së Integritetit Europian **kategoria: III-a/1**

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shpall listën e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : lsaliaj@bashkiamallakaster.gov.al

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA MALLAKASTËR**

LAURETA SALIAJ

